



RAPORT
VJETOR
2014



Të Dashur miq,

Viti 2014 ka qenë një vit i rëndësishëm për sektorin elektroenergjistik shqiptar në tërësi, por edhe për Operatorin e Sistemit të Transmetimit, si një ndër pjestarët kryesorë të këtij sektori. OST sh.a. ka vijuar të përmbushë detyrimet e veta ligjore, duke garantuar kapacitetet e nevojshme për furnizimin me energji elektrike të tregut të brendshëm, si dhe duke realizuar volume të konsiderueshme shkëmbimesh në tregun rajonal të energjisë. Përgjatë këtij viti OST sh.a. realizoi 100 % transmetimin e energjisë elektrike për të mbuluar konsumin e brendshëm në nivelin 7.473 TWh, nga të cilat 4. 406 TWh nga prodhimi i brendshëm dhe 3.067 TWh import nga tregu rajonal i energjisë elektrike.

Një ndër fushat që ka pasur një vëmendje e veçantë është dhe realizimi i projekteve, të cilat janë në fazën e implementimit, por edhe sigurimi i financimeve të nevojshme nga institucionet financiare për të financuar projektet e reja zhvillimore për sistemin e transmetimit.

Aktualisht është duke u punuar për realizimin e disa projekteve të rëndësishme. Projekti i linjës së interkonjeksionit 400 kV Shqipëri – Kosovë, parashikohet të jetë në operim në fillim të vitit 2016. Gjatë këtij viti, elemente të veçanta për përforcimin e rrjetit të transmetimit 110 kV të Jugut të Shqipërisë kanë përfunduar dhe janë në operim. Ky projekt pritet të përfundojë tërësisht në fund të vitit 2015. Ndërtimi i Qendrës së re Kombëtare Dispeçer dhe Zyrave Qendrore të OST sh.a. ka vijuar me një ecuri të lartë dhe, gjithashtu, këtë vit u vu në funksionim të plotë sistemi SCADA/EMS.

OST sh.a. po vijon punën për sigurimin e financimit për disa projekte të tjera të rëndësishme, të cilat do të vijojnë të përmirësojnë cilësinë e shërbimit dhe besueshmërinë për sistemin e transmetimit për vitet në vijim. Vlen të përmenden projekte të tilla si linja 220 kV me dy qarqe, “Tirana 2 Rashbull” dhe fuqëzimi i Nënstacionit të Rashbullit; përforcimi i Rrjetit Unazor 110 kV të Tiranës dhe ndërtimi i nënstacionit të ri 400/110 kV “Tirana 3”, linja e interkonjeksionit 400 kV Maqedoni - Shqipëri dhe zgjerimi i nënstacionit 400 kV “Elbasan 2”, si dhe linja e transmetimit 400 kV Elbasan 2 – Fier dhe zgjerimi i nënstacionit të Fierit.

Viti 2014 ka qenë një vit shumë i rëndësishëm për procesin e anëtarësimit të plotë të OST sh.a. në ENTSO – E. Më 10 dhjetor 2014 OST sh.a. nënshkroi në Bruksel marrëveshjen afatgjatë për operimin sinkron të Sistemit Elektroenergjetik Shqiptar me sistemin e Europës Kontinentale. Nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje i bëri të mundur OST sh.a. të jetë pjesëmarrëse me specialistët e saj në të gjitha nivelet e përfaqësimit të ENTSO – E.

Në saje të punës së bërë, OST sh.a. do të vijojë të jetë një kompani lider në tregun shqiptar të energjisë elektrike dhe për vitet në vijim, duke përmbushur të gjitha detyrimet ligjore dhe teknike, duke garantuar përdoruesit e Sistemit të Transmetimit që do të kenë gjithmonë një shërbim cilësor dhe me standarde europiane.

*Me respekt,
Dr. Ing. Engjëll Zeqo,
Administrator i OST sh.a.*

Përmbajtja

I. PREZANTIMI I OST SH.A.	01
1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM	01
2. MISIONI, VIZIONI, PRIORITETET DHE STRATEGJITË	03
3. KORNIZA LIGJORE DHE RREGULLATORE	04
4. ÇËSHTJET SOCIALE DHE MJEDISORE	05
II. MODELI I DREJTIMIT TË OST SH.A.	06
1. STRUKTURAT DREJTUESE	06
2. STRUKTURA ORGANIZATIVE	06
3. MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE	08
III. DREJTIMI OPERATIV I SISTEMIT	09
1. FUNKSIONI I DREJTORISË SË DREJTIMIT OPERATIV TË SISTEMIT	09
2. ORGANOGRAMA	09
3. AKTIVITETI GJATË VITIT 2014	10
4. AKTIVITETI GJATË VITIT 2014 SIPAS SEKTORËVE TË DDOS	18
IV. MIRËMBAJTJA DHE SHFRYTËZIMI I TRANSMETIMIT	20
1. FUNKSIONI I DREJTORISË SË MIRËMBAJTJES DHE SHFRYTËZIMIT TË TRANSMETIMIT	20
2. ASETET E SISTEMIT TË TRANSMETIMIT	20
3. ORGANOGRAMA	21
4. AKTIVITETI GJATË VITIT 2014 SIPAS SEKTORËVE	21
V. OPERATORI I TREGUT	30
1. FUNKSIONI I DREJTORISË SË OPERATORIT TË TREGUT	30
2. ORGANOGRAMA	30
3. AKTIVITETI GJATË VITIT 2014	31
VI. PLANIFIKIMI DHE ZHVILLIMI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT	36
1. PROJEKTET PËR ZHVILLIMIN E SISTEMIT TË TRANSMETIMIT	36
2. PROJEKTET NË PROCES IMPLEMENTIMI	36
3. PROJEKTE TË RËNDËSISHME PËR ZHVILLIMIN E SISTEMIT SHQIPTAR TË TRANSMETIMIT	43
VII. PASQYRAT FINANCIARE	47
1. PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	47
2. PASQYRA E FITIMIT (HUMBJES) DHE E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE	48

I. Prezantimi i OST sh.a.

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Sistemi i Transmetimit të Energjisë Elektrike në Shqipëri drejtohet nga Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh. a.), një kompani publike me 100% të aksioneve në pronësi të shtetit. OST sh. a. është krijuar në 14.07.2004 si rezultat i ristrukturimit dhe ndarjes së Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare, nga një shoqëri e integruar vertikalisht me funksionet e gjenerimit, transmetimit dhe shpërndarjes në tri kompani të veçanta.

Bazuar në kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, OST sh. a. ka përgjegjësinë të operojë, të mirëmbajë dhe të zhvillojë rrjetin e sistemit të transmetimit, duke përfshirë interkoneksionet me sistemet e tjera ndërkufitare, për të siguruar aftësinë afatgjatë të sistemit për plotësimin e kërkesave të arsyeshme për transmetimin e energjisë elektrike.

Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) është një nga pjesëtarët kryesorë të tregut të energjisë elektrike në Shqipëri. Bazuar në këtë rol të rëndësishëm, kompania e mbështet zhvillimin e vet në planet afatmesme dhe afatgjata të zhvillimit të sektorit të energjisë elektrike në vend.

Operatori i Sistemit të Transmetimit ushtron veprimtarinë e tij i ndarë nga aktivitetet e tjera në sektorin e energjisë elektrike, si: prodhimi, shpërndarja, tregtimi dhe furnizimi me energji elektrike, në përputhje me parimet dhe kërkesat e përcaktuara në ligjin për Sektorin e Energjisë Elektrike.

Më poshtë po parashtrijmë në mënyrë të detajuar përgjegjësitë kryesore të OST sh. a. që burojnë nga aktet ligjore, nënligjore dhe rregullatore në fuqi.

Menaxhimi i flukseve të energjisë

OST sh.a ka përgjegjësi të menaxhojë flukset e energjisë elektrike në rrjetin e transmetimit, duke marrë parasysh shkëmbimet e energjisë elektrike me sistemet e tjera të ndërlidhura dhe siguron të gjitha shërbimet ndihmëse të nevojshme.

Siguria e sistemit

Siguron aftësinë afatgjatë të sistemit për të plotësuar kërkesën e arsyeshme për transmetimin e energjisë elektrike, duke operuar, ruajtur dhe zhvilluar në mënyrë të sigurt, të besueshme dhe efikase sistemin e transmetimit, në përputhje me kërkesat ligjore. Ruan informacionin e nevojshëm për vlerësimin e parametrave të cilësisë së furnizimit me energji elektrike në sistemin e transmetimit, bazuar në rregullat për cilësinë e furnizimit me energji elektrike, përfshirë informacionin mbi sigurinë e furnizimit, cilësinë e tensionit, cilësinë e shërbimit dhe informacione të tjera të përcaktuara nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE).

Lidhja me sistemin e transmetimit

Harton dhe publikon procedura transparente, të efektshme dhe jodiskriminuese për lidhjen e përdoruesve dhe të centraleve të reja të prodhimit të energjisë me sistemin e transmetimit. Siguron lidhjen e përdoruesve të sistemit me rrjetin e transmetimit, si dhe ofrimin e shërbimeve në bazë të parashikimeve

të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, që rregullojnë procesin e lidhjes dhe shfrytëzimit të rrjetit. Krijon një mekanizëm të trajtimit të ankesave për çështjet që kanë të bëjnë me aksesin dhe përdorimin e rrjetit të transmetimit.

Humbjet dhe shërbimet ndihmëse

Siguron energjinë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit, si dhe rezervën e energjisë dhe shërbimet e tjera ndihmëse, të kërkuara për operimin e sigurt të sistemit, bazuar në parimet e transparencës, mosdiskriminimit, rregullave të tregut dhe kostos minimale. Kryen një analizë vjetore të humbjeve në rrjetin e transmetimit, si dhe harton e zbaton masat e reduktimit të humbjeve dhe masa të tjera të eficiencës së energjisë.

Shërbimet e balancimit

Kryen balancimin e sistemit, mbështetur në parime objektive, transparente e jodiskriminuese, në përputhje me Kodin e Rrjetit të Transmetimit dhe Rregullat e Tregut. Shkëmben ose ndan shërbimet e balancimit me operatorët e sistemit të transmetimit të shteteve fqinje për rregullimin e frekuencës brenda rrjetit, në përputhje me marrëveshjet operationale ndërmjet operatorëve të sistemit të transmetimit të rajonit dhe të dispozitave të këtij ligji për promovimin e bashkëpunimit rajonal.

Alokimi i kapaciteteve

Menaxhon kapacitetin ndërkufitar, si dhe kryen alokimin e kapaciteteve me operatorët fqinjë të rrjeteve të transmetimit, në bazë të kriterëve objektive, transparente e jodiskriminuese dhe publikon informacionin në lidhje me kapacitetet ndërkufitare.

Transmetimi i të dhënave

Instalon dhe përpunon të gjitha llojet e informacionit, komunikimeve dhe sistemeve, duke përfshirë gjithashtu edhe sistemin wireless, të nevojshëm për sistemin e transmetimit. Në varësi të mundësive, një pjesë e infrastrukturës së fibrës optike dhe/ose kapaciteteve të rrjetit të komunikimit të shpejtësive të larta mund të jepen në përdorim pa dëmtuar dhe rrezikuar veprimtaritë dhe rrjetet e tjera brenda kuadrit të legjislacionit përkatës, në përputhje me opinionin e ERE-së.

Sigurimi i informacionit

Ofron ndaj përdoruesve të sistemit të gjithë informacionin e nevojshëm për përdorimin e efektshëm të rrjetit. Shkëmben informacionin e kërkuar me operatorët e transmetimit të sistemeve fqinje, me qëllim funksionimin e sigurt dhe efikas, zhvillimin e koordinuar dhe ndërveprimin e sistemeve.

Bashkëpunon dhe raporton pranë ERE

Përgatit dhe dërgon për miratim në ERE të gjitha aktet nënligjore dhe rregullatore sipas detyrimeve të parashikuara në ligj, të tilla si: Kodi i Transmetimit, Rregullat e Tregut, Rregullat e Lidhjeve të Reja, Rregulloret për Alokimin e Kapaciteteve të Interkonjeksionit etj. Raporton në ERE në lidhje me aktivitetin e saj në përputhje me kërkesat dhe afatet ligjore.

MISIONI, VIZIONI, PRIORITETET DHE STRATEGJITË 2

MISIONI

OST sh. a. është një kompani, e cila siguron shërbime me cilësi të lartë për të gjithë përdoruesit e Sistemit të Transmetimit, bazuar në standardet dhe praktikën më të mira, të cilat aplikohen nga operatorët e sistemeve të transmetimit të ENTSO-E, duke kontribuar në zhvillimin ekonomik të Shqipërisë dhe në shkëmbimin e sigurt dhe cilësor të energjisë elektrike në vend dhe rajon.

VIZIONI

Operatori i Sistemit të Transmetimit Shqipëria duhet zhvillojë sistemin e transmetimit të energjisë elektrike bazuar në standardet më të larta teknike, me qëllim që:

- të ketë një sistem të besueshëm dhe të qëndrueshëm të transmetimit të energjisë;
- të ofrojë shërbime cilësore me koston sa më të ulët të mundshme për përdoruesit e Sistemit të Transmetimit;
- të zgjerojë dhe të zhvillojë Sistemin e Transmetimit, me qëllim për të përmbushur kërkesën aktuale dhe të ardhshme për energji elektrike në tregun vendas dhe rajonal të energjisë elektrike;
- të sigurojë aplikimin e standardeve më të larta mjedisore dhe sociale në operimin dhe zhvillimin e rrjetit të transmetimit.

PRIORITETET DHE STRATEGJITË

Prioritetet e OST sh. a janë të vendosur në përputhje me misionin dhe vizionin e kompanisë. Ndër prioritetet dhe strategjitë kryesore mund të listojmë:

- Funksionimin si një entitet efektiv dhe eficient për të arritur përmirësime të vazhdueshme për ruajtjen dhe garantimin e qëndrueshmërisë së sistemit elektroenergetik shqiptar.
- Zhvillimin e rrjetit të transmetimit në përputhje me planifikimin afatgjatë dhe planet e zhvillimit të sektorit të energjisë elektrike si një e tërë për të rritur kapacitetin e shkëmbimit me vendet fqinje dhe cilësinë e shërbimit ndaj përdoruesve të Sistemit të Transmetimit.

- Sigurimin e kushteve të përshtatshme të operimit të tregut të energjisë elektrike në përputhje me zhvillimet e pritshme të tregut.
- Bashkëpunimin e ngushtë me Entin Rregullator të Energjisë për të hartuar rregulla tregu, të cilat sigurojnë një model transparent dhe konkurrues të tregut të energjisë elektrike.
- Sigurimin e stabilitetit financiar të kompanisë.
- Sigurimin e mjedisit punëdhënës atraktiv në tregun e punës në Shqipëri.
- Respektimin e të gjitha politikave mjedisore në menaxhimin dhe zhvillimin e rrjetit të transmetimit.

OST sh. a. është vazhdimisht në kërkim të përmirësimit të performancës së saj teknike, ekonomike dhe financiare për të përmbushur standardet më të mira ndërkombëtare të komunitetit të tregut të energjisë elektrike dhe të organizatave europiane, të cilat nxisin dhe monitorojnë hapjen e tregut të brendshëm të energjisë elektrike, si dhe integrimin e këtij tregu në tregun rajonal dhe europian të energjisë.

Në dhjetor të vitit 2014, OST sh. a. ka nënshkruar me të gjithë OST-të, anëtarë të ENTSO-E, Marrëveshjen LTA (Long Term Agreement), duke bërë kështu një hap më shumë drejt anëtarësimit të saj të plotë në këtë organizatë. Në përputhje me parashikimet e LTA, OST sh.a ka fituar të drejtën për të marrë pjesë në të gjitha strukturat e organizimit teknik të ENTSO-E, përfaqësuar nga ekspertët përkatës dhe merr pjesë në Asamblenë e Përgjithshme të ENTSO-E. Duke filluar nga viti 2012, OST-ja ka marrë pjesë në mënyrë aktive në procesin e krijimit të Zyrës së Koordinuar të Ankandëve në Europën Juglindore (SEE CAO) dhe aktualisht është një nga OST-të anëtare të saj, duke përfshirë Kroacinë, Bosnjë-Hercegovinën, Greqinë, Malin e Zi, Kosovën dhe Turqinë.

SEE CAO ka filluar tashmë procesin e ankandëve mujore, të kapaciteteve të interkonjeksionit për vitin 2015.

SEE CAO është një iniciativë shumë e rëndësishme e bashkëpunimit rajonal ndërmjet OST-ve të rajonit dhe krijon kushte të mira për zhvillimin e tregut të përbashkët të energjisë në rajon.



3 KORNIZA LIGJORE DHE RREGULLATORE

Shqipëria është një ndër vendet nënshkruese të Traktatit të Komunitetit të Energjisë në lidhje me zhvillimin rajonal të sektorit të energjisë elektrike dhe të gazit natyror në Europën Juglindore. Ky traktat u kërkon vendeve anëtare dhe vendit tonë, që të përafrojnë dhe të përshtatin kuadrin ligjor me “acquis communautaire” të BE-së në katër fusha, duke përfshirë direktivën në tregun e brendshëm të energjisë elektrike dhe të rregullores për shkëmbimin e energjisë elektrike ndërmjet vendeve fqinje. Gjatë vitit 2014 është punuar në mënyrë aktive në grupet e përbashkëta të punës për përgatitjen e projektligjit të ri të sektorit të energjisë. Ky projektligj, i cili është në përputhje me paketën e tretë legjislativë të BE-së, i përgatitur nën kryesimin e Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, me pjesëmarrjen e tri shoqërive kryesore të sektorit elektroenergjetik dhe aktorëve të tjerë të tregut të energjisë, me bashkëpunimin e USAID-it dhe këshillimin e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, krijon një panoramë të re të tregut të energjisë. Operatorit të Sistemit të Transmetimit, si një nga kompanitë kryesore të sistemit elektroenergjetik dhe tregut të energjisë elektrike, i ngarkohen një sërë detyrimesh dhe i dalin detyra konkrete për përgatitjen e akteve nënligjore e rregullatore, me qëllim përshtatjen me kërkesat e një tregu të ri të energjisë elektrike, në mënyrë sa graduale, aq edhe emergjente.

Ligji i ri, ashtu sikurse edhe anëtarësimi me të drejta të plota në ENTSO-E (që është tashmë shumë i afërt), e vendos OST-në përballë një perspektive të re, e cila kërkon përshtatjen e sektorit elektroenergjetik, tregut të energjisë dhe, si rrjedhojë, edhe OST-së me modelet europiane.

4 ÇËSHTJET SOCIALE DHE MJEDISORE

OST-ja vlerëson ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit, si një prej detyrave të saj primare dhe është vazhdimisht duke punuar për të përmirësuar performancën mjedisore të kompanisë. OST-ja ka hartuar tashmë dhe zbaton politika mjedisore, të cilat janë publike dhe të botuara në faqen e internetit të kompanisë. Zbatimi i politikave të mjedisit realizohet nëpërmjet Planeve të Veprimit, të cilat detajojnë të gjitha aspektet e identifikuar mjedisore. Politika e OST-së për mjedisin mbështetet në tri shtylla kryesore, që janë si më poshtë:

- Menaxhimi i çështjeve mjedisore të OST-së është zhvilluar në përputhje me ligjet e vendit, rregulloret dhe kërkesat mjedisore të energjisë elektrike;
- Përmirësimi i performancës mjedisore nëpërmjet sensibilizimit të përshtatshëm të stafit dhe trajnimet relevante për këtë çështje;
- Parandalimi dhe zbutja e ndikimeve mjedisore, monitorimi, kontrolli i shkarkimit dhe ndotja brenda standardeve të pranura për të menaxhuar mbrojtjen dhe qëndrueshmërinë e burimeve natyrore.

Në bazë të politikave të mjedisit, OST ka caktuar objektivat mjedisore të kompanisë dhe ndikimet mjedisore që rrjedhin nga ushtrimi i veprimtarisë së kompanisë. Një bazë e fortë për menaxhimin e çështjeve mjedisore është Sistemi i Menaxhimit Mjedisor në përputhje me standardin europian ISO 14001.

II Modeli i drejtimit të OST sh.a.

1 STRUKTURAT DREJTUESE

OST sh. a. drejtohet nga:

Këshilli Mbikëqyrës dhe
Administratori.



Këshilli Mbikëqyrës përbëhet nga gjashtë (6) anëtarë të emëruar nga Asambleja e Përgjithshme.

- | | |
|-----------------------|----------------------------------|
| 1. Pajtim Bello | (Kryetar i Këshillit Mbikëqyrës) |
| 2. Dorian Duçka | (Anëtar) |
| 3. Ilir Bejtja | (Anëtar) |
| 4. Entela Cipa | (Anëtar) |
| 5. Evisi Kopliku | (Anëtar) |
| 6. Stefanaq Koçollari | (Anëtar) |

Me vendimin nr. 3, datë 30.09. 2013, Këshilli Mbikëqyrës i OST sh. a. ka emëruar z. Engjëll Zeqo administrator të OST sh.a.

2 STRUKTURA ORGANIZATIVE

Administrata qendrore



GJITHSEJ: 730 PUNONJËS

3 MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE

Struktura e organizimit të OST-së është e thjeshtë dhe fleksibël dhe lejon përmirësime të mëtejshme dhe krijimin e njësive të reja në bazë të kësaj strukture.

Stafi mesatar i OST-së për vitin 2014 përbëhet nga 730 punonjës. Stafi i OST-së është i motivuar dhe i aftë për të përbushur objektivat strategjike dhe zbatimin e projekteve të reja, të cilat janë gati në fazën përfundimtare me efikasitet të lartë.

Kërkesat e OST-së për rekrutim të stafit të ri janë të lidhura ngushtë me detyrimet që vijnë si rezultat i

respektimit të standardeve ligjore, si dhe i kërkesave të anëtarësimit në ENTSO-E.

Politikat e burimeve njerëzore mbulojnë planifikimin e rekrutimeve të burimeve njerëzore, rekrutimin dhe përzgjedhjen, zhvillimin e aftësive, menaxhimin të performancës dhe shpërblimet, barazinë gjinore dhe përfshirjen e pakicave të tjera etnike.

Operatori i Sistemit të Transmetimit ka në strukturën e tij një staf prej 730 të punësuarish gjithsej, 159 prej të cilëve punojnë në selinë kryesore.

Sipas gjinisë, moshës dhe nivelit arsimor struktura e OST sh.a paraqitet si më poshtë:

Mosha	Administrata	NJMT	Njësia Tiranë	Njësia Fier	Njësia Shkodër	Njësia Elbasan	Njësia Korçë	Njësia Burrel	OST
<30 vjeç	31	4	10	4	13	4	3	2	71
30 - 40 vjeç	40	10	16	14	22	3	7	6	118
40 - 50 vjeç	24	14	11	25	38	21	10	9	152
50 - 65 vjeç	64	39	74	53	52	42	20	45	389
Arsimi	Administrata	NJMT	Njësia Tiranë	Njësia Fier	Njësia Shkodër	Njësia Elbasan	Njësia Korçë	Njësia Burrel	OST
I lartë	117	15	35	12	20	11	12	9	231
I mesëm	40	32	68	79	95	55	28	43	440
I detyruar	2	20	8	5	10	4	0	10	59
Lloji i fakultetit	Administrata	NJMT	Njësia Tiranë	Njësia Fier	Njësia Shkodër	Njësia Elbasan	Njësia Korçë	Njësia Burrel	OST
Inxhinieri	78	8	29	10	15	6	8	7	161
Ekonomik	19	5	4	2	3	4	3	1	41
Drejtësi	8	0	0	0	1	0	0	0	9
Filologji	5	2	1	0	1	1	0	0	10
Shkenca sociale	6	0	1	0	0	0	1	1	9
Biokimi	1	0	0	0	0	0	0	0	1
I mesëm	40	32	68	79	95	55	28	43	440
I detyruar	2	20	8	5	10	4	0	10	59
Gjinia	Administrata	NJMT	Njësia Tiranë	Njësia Fier	Njësia Shkodër	Njësia Elbasan	Njësia Korçë	Njësia Burrel	OST
Meshkuj	93	56	85	86	113	50	32	56	571
Femra	66	11	26	10	12	20	8	6	159
Totali i njësive	159	67	111	96	125	70	40	62	730

III Drejtimi operativ i sistemit

1 Funkzioni i Drejtorisë së Drejtimit Operativ të Sistemit

OST sh.a operon sistemin elektroenergjetik nëpërmjet Drejtorisë së Drejtimit Operativ, duke marrë parasysh sigurimin e të gjitha shërbimeve ndihmëse që lidhen me ruajtjen e qëndrueshmërisë së sistemit dhe shkëmbimet me sistemet e tjera.

OST, si Operator i Sistemit, kryen funksionet e mëposhtme:

1. Bën parashikimin e punës së Sistemit Energjetik në terma afatshkurtër e afatmesëm, duke konsideruar parashikimin e kërkesës për energji elektrike.
2. Operon sistemin e prodhimit, transmetimit, duke kontrolluar e garantuar nivelin e sigurimit të furnizimit me energji elektrike konform Kodit të Rrjetit dhe standardeve të ENTSO-E.
3. Në bashkëpunim me TSO-të fqinje dhe në zbatim të metodologjisë së vendosur nga ENTSO-E, përcakton kapacitetin transmetues ndërkufitar për çdo kufi e drejtim të fluksit të energjisë, për periudhat kohore vjetore, mujore dhe ditore, duke hapur rrugën tregut të energjisë elektrike dhe shkëmbimeve të energjisë që realizohen nga përdoruesit e rrjetit, pjesëtarët e tregut të energjisë elektrike.
4. Menaxhon shërbimet ndihmëse të domosdoshme për funksionimin normal të SE, dhe kërkesa të tjera operative të lidhura me balancimin dhe cilësinë e furnizimit konform standardeve teknike dhe

përcaktimeve të Kodit të Rrjetit dhe Rregullave të Tregut të energjisë elektrike.

5. Menaxhon gjeneruesit dhe kërkesën e energjisë elektrike në kohë reale, duke siguruar balancën ndërmjet gjenerimit, shkëmbimit dhe konsumit të energjisë elektrike.
6. Planifikon mbulimin e kërkesës me bazë ditore/orare; përgatit planin e prodhimit të energjisë, skedulimin orar, për çdo central dhe kontrollon nivelin e sigurisë së furnizimit duke aplikuar kriterin e sigurisë N-1.
7. Bën shkëmbimin dhe harmonizimin e skedulimit orar të energjisë me OST-të fqinje dhe qendrën koordinative të rajonit për ditën e ardhshme, si dhe llogaritjen e shkëmbimit të energjisë për çdo interkonektor për ditën paraardhëse.
8. Planifikon dhe autorizon daljen nga puna të elementeve të rrjetit, duke garantuar sigurinë e punës së sistemit në koordinim me përdoruesit e rrjetit.
9. Mban dhe zhvillon bazën respektive të të dhënave dhe përgatit informacionin e përshtatshëm për punën e Sistemit Energjetik dhe e vë në dispozicion të autoriteteve respektive.
10. Analizon punën e Sistemit Energjetik dhe propozon masa konkrete për ruajtjen e sigurisë së punës, duke mbajtur lidhjet e nevojshme brenda kompanisë me përdoruesit e rrjetit, OST-të e rajonit dhe Qendrën Koordinative Rajonale.


2 ORGANOGRAMA



3 AKTIVITETI GJATË VITIT 2014

Në përputhje me detyrën funksionale, kjo drejtori është fokusuar në përcaktimin e mënyrës së shfrytëzimit të Sistemit Transmetues në aspektin e qëndrueshmërisë dhe të sigurisë së punës së sistemit, e lidhur kjo ngushtësisht me drejtimin operativ të SE në tërësi, në zbatim të Kodit të Rrjetit të Transmetimit, Modelit dhe Rregullave të Tregut në Shqipëri.

Struktura e Sistemit Elektroenergjetik Shqiptar për vitin 2014 (Kapaciteti Nominal Gjenerues të MW në NS dhe Kapaciteti Nominal i Transformimit të SE të OST sh.a në MVA) paraqitet si më poshtë:



Të dhënat kryesore të rrjetit transmetues për vitin 2014

OST zotëron dhe operon 15 nënstacione 400 kV, 220 kV dhe 150 kV me një fuqi totale të instaluar prej 3826 MVA. Rrjeti 220 kV punon në qark të mbyllur duke lidhur centralet kryesore në veri të vendit me ngarkesat e përqendruara të konsumit, kryesisht në qendër dhe jug të vendit. Rrjeti 110 kV shtrihet në gjithë territorin e vendit dhe përdoret për furnizimin e Sistemit të Shpërndarjes dhe Konsumatorëve të Kualifikuar. Një pjesë e këtij rrjeti punon në qark të mbyllur dhe pjesa tjetër në formë radiale.

Hidrocentralet dominojnë sektorin e gjenerimit të vendit dhe prodhimi i energjisë elektrike në Shqipëri është shumë i varur nga kushtet hidrologjike përgjatë gjithë vitit, duke variuar afërsisht nga 3 TWh në një vit të thatë, në 7 TWh në një vit me lagështirë. Ky ndryshim i

madh i prodhimit në vitet e thata dhe në vitet e lagështa e ul besueshmërinë e sistemit gjenerues dhe kërkon domosdoshmërisht sigurimin e energjisë elektrike nga importi për të plotësuar kërkesën e vendit për energji elektrike.


OST aktualisht operon sinkron me rrjetin e transmetimit europian ENTSO-E nëpërmjet linjave të interkonjeksionit me vendet fqinje të tensionit 400 kV dhe 220 kV. Në janar të vitit 2015 u nënshkrua Marrëveshja e Operimit LTA (Long Term Agreement) për Operimin Sinkron me rrjetin e transmetimit Europian ENTSO-E, nëpërmjet të cilës vendi ynë ka statusin e anëtarit me të drejta të plota të këtij grupimi të rrjeteve nacionale të Transmetimit të vendeve europiane, ENTSO-E.

Prodhimi, shkëmbimi, konsumi në TW/h


Të dhënat e 10 viteve të fundit (2005-2014)

Për të mbuluar kërkesën për energji elektrike, Sistemi Elektroenergjetik Shqiptar është bërë një importues neto i energjisë elektrike, për rreth dy dekada, me përjashtim të vitit 2010, ku shkëmbimi neto rezultoi në

7320 GWh në drejtimin eksport, si rrjedhojë e prurjeve të bollshme në kaskadën e Drinit, që ishin rreth dy herë më të larta së niveli i prurjeve mesatare shumëvjeçare. në tabelën paraqitet prodhimi, konsumi dhe shkëmbimet gjatë këtyre viteve:




Të dhënat për vitin 2014



Viti 2014 konsiderohet si një vit normal lidhur me temperaturat e ambientit dhe parametrat kryesorë energjetikë të sistemit tonë. Konsumi total rezultoi 7.473 TWh, ku 4.406 TWh u gjeneruan nga prodhimi i vendit dhe 3,067 TWh u importuan. Prurjet në kaskadën e Drinit, në pranverë dhe në vjeshtë, rezultuan diçka më të mëdha se prurjet e parashikuara (mesatare llogaritëse), gjë e cila ndihmoi në mbajtjen e niveleve relativisht të larta në liqenet e kaskadës, e si rrjedhim, edhe në disponibilitetin e një rezerve energjetike të mjaftueshme. Importi i energjisë elektrike në tre muajt e parë të vitit ishte pak më i madh se sasia e importit të parashikuar, për shkak të prurjeve të pamjaftueshme në kaskadë, dhe pamundësisë së KESH-it për të përballuar kërkesën e OSHE-së. Gjithsesi, në muajt e tjerë të vitit, importi ishte pak më i vogël se parashikimi, si rrjedhojë e rritjes së prurjeve dhe e niveleve të rezervuarëve të

kaskadës, por edhe e trendit në ulje të konsumit të vendit. Fizikisht, sasia e energjisë elektrike të importuar u realizua në masën 87% nga kufiri me Malin e Zi dhe 13% nga kufiri me Greqinë. Përgjithësisht, konsumi i energjisë elektrike ishte në linjë me vlerat e parashikuara në planifikimin vjetor, me përjashtim të dy muajve të fundit, ku u ballafaquam me një ulje të ndjeshme të konsumit total të vendit (rreth 10% më pak se e njëjta periudhë e një viti më parë), si rrjedhojë e masave të marra nga Qeveria dhe OSHE për uljen e humbjeve joteknike në rrjetin e shpërndarjes, si dhe rritjen e nivelit të arkëtimeve. Gjatë vitit 2014 nuk jemi ballafaquar me avari të rënda apo ngjarje të paparashikuara, të shoqëruara me ndërprerjen apo kufizimin e furnizimit me energji elektrike të konsumatorëve të vendit.




Balanca e energjisë në Sistemin Energjetik


Një balancë e qëndrueshme ndërmjet prodhimit dhe konsumit, është parakusht për një Sistem të Qëndrueshëm, që garanton sigurinë e furnizimit me frekuencën e vendosur prej 50 Hz. Kjo nënkupton që prodhimi dhe konsumi duhet të koordinohen në mënyrë të tillë, që të ruhet balanca e kërkuar. Operimi i Përditshëm i Sistemit përfshin harmonizimin (ruajtjen e balancës) ndërmjet gjenerimit dhe konsumit,

në kohë reale dhe në mënyrë të vazhdueshme, me qëllim sigurimin e stabilitetit dhe ruajtjen e parametrevë cilësorë në një nivel të kënaqshëm të tensionit dhe frekuencës. Si rrjedhojë e vënies në punë të rregullimit sekundar AGC-LFC në të tri centralët e KESH-it dhe kujdesit të treguar nga operatorët tanë ka pasur një rritje cilësore të mbajtjes nën kontroll të devijimeve, krahasuar me vitin 2013.


Në grafikun e mëposhtëm jepen devijimet orare nga Programi i Shkëmbimit për vitin 2014.



Në diagramën e mëposhtme paraqitet kurba e vazhdimësisë së ngarkesës së regjistruar të vendit, nga ku duket se për rreth 3000 orë në vit ngarkesa e konsumit të vendit është e rendit mbi 1000 MW.




Në diagramet e mëposhtme, për dy muajt karakteristikë të vitit, janar dhe korrik, jepen realizimi i parametrevë kryesore si: prodhimi, shkëmbimi, konsumi, si dhe krahasimi me parashikimin e tyre të bërë në fillim të vitit.



Janar

Periudha	HPP (MW)	TPP (MW)	GEN (MW)	EXCH (MW)	Supply (MW)	Kërkesa e parashikuar (MW)	Diferenca me parashikimin (MW)
00 01	285	0	285	-430	715	745	30
01 02	181	0	181	-448	629	650	21
02 03	141	0	141	-444	585	600	15
03 04	131	0	131	-435	566	585	19
04 05	125	0	125	-449	573	590	17
05 06	181	0	181	-464	645	665	20
06 07	381	0	381	-452	833	845	12
07 08	658	0	658	-432	1,089	1,110	21
08 09	779	0	779	-405	1,184	1,225	41
09 10	794	0	794	-400	1,194	1,245	51
10 11	766	0	766	-402	1,168	1,225	57
11 12	744	0	744	-402	1,145	1,210	65
12 13	724	0	724	-413	1,137	1,200	63
13 14	725	0	725	-427	1,151	1,215	64
14 15	743	0	743	-421	1,164	1,225	61
15 16	754	0	754	-422	1,175	1,245	70
16 17	812	0	812	-426	1,238	1,305	67
17 18	943	0	943	-406	1,349	1,410	61
18 19	954	0	954	-408	1,362	1,420	58
19 20	952	0	952	-406	1,358	1,410	52
20 21	903	0	903	-412	1,315	1,360	45
21 22	801	0	801	-409	1,211	1,255	44
22 23	634	0	634	-415	1,050	1,080	30
23 24	430	0	430	-420	850	880	30
Total	14,541	0	14,541	-10,144	24,686	25,700	1,014




Korrik

Period	HPP (MW)	TPP (MW)	GEN (MW)	EXCH (MW)	Supply (MW)	Kërkesa e parashikuar (MW)	Diferenca me parashikimin (MW)
00 01	293	0	293	-306	598	655	57
01 02	225	0	225	-305	530	590	60
02 03	196	0	196	-309	505	565	60
03 04	177	0	177	-314	491	550	59
04 05	173	0	173	-314	487	550	63
05 06	210	0	210	-316	527	590	63
06 07	326	0	326	-309	635	690	55
07 08	462	0	462	-304	766	815	49
08 09	552	0	552	-300	852	910	58
09 10	595	0	595	-288	883	935	52
10 11	603	0	603	-287	891	950	59
11 12	622	0	622	-278	900	960	60
12 13	622	0	622	-279	901	960	59
13 14	614	0	614	-281	895	950	55
14 15	588	0	588	-281	869	930	61
15 16	568	0	568	-285	852	915	63
16 17	563	0	563	-285	847	915	68
17 18	568	0	568	-297	865	930	65
18 19	586	0	586	-298	884	945	61
19 20	618	0	618	-297	915	970	55
20 21	689	0	689	-296	985	1,045	60
21 22	702	0	702	-293	995	1,060	65
22 23	564	0	564	-304	868	940	72
23 24	401	0	401	-316	716	780	64
Total	11,514	0	11,514	-7,143	18,657	20,100	1,443

Në tabelën e mëposhtme jepet bilanci i energjisë elektrike të transmetuar në rrjetin e transmetimit gjatë vitit 2014.

Nr.	Përshkrimi	Njësia	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Vjetore
I	Energjia totale që hyn në Sistemin e OST	GWh	784.8	663.8	696.9	610.0	584.7	569.4	589.7	637.1	574.8	621.1	630.0	737.1	7,699.26
a	- Prodhimi vendas	*	446.53	321.04	369.21	310.74	321.62	354.04	350.92	381.77	337.84	367.01	333.08	449.47	4,343.27
b	- Energjia e marrë	*	338.25	342.72	327.66	299.23	263.04	215.36	238.82	255.35	237.00	254.08	296.87	287.61	3,355.99
II	ENERGJIA TOTALE E TRANSMETUAR	GWh	768.14	649.53	682.34	597.62	571.91	557.36	576.68	622.13	563.04	609.40	617.58	722.59	7,538.31
a	- Energjia e dhënë	*	23.79	10.44	22.95	4.96	20.35	34.27	17.40	22.72	25.25	22.49	28.27	55.60	288.50
b	- Energji e transmetuar për OSSh	*	701.57	597.75	610.79	532.66	491.97	466.89	509.21	543.25	471.41	513.11	516.42	597.52	6,552.57
c	- Energji e transmetuar për klientët e kualifikuar	*	42.78	41.34	48.61	59.99	59.59	56.20	50.06	56.16	66.38	73.80	72.88	69.47	697.25
III	Humbje në rrjetin e Transmetimit + NV	GWh	16.65	14.23	14.53	12.35	12.74	12.03	13.07	14.98	11.80	11.70	12.37	14.49	160.942
IV	Humbje në rrjetin e Transmetimit	%	2.12	2.14	2.08	2.03	2.18	2.11	2.22	2.35	2.05	1.88	1.96	1.97	2.09

Energji totale që hyn në sistemin e OST-së



Energji totale e transmetuar



Menaxhimi i Sistemit duke shfrytëzuar sistemin SCADA/EMS

Në Operatorin e Sistemit të Transmetimit, OST sh.a, është implementuar platforma e menaxhimit të rrjetit energjetik: "Network Manager". Kjo platformë ofron të gjitha funksionalitetet e SCADA/EMS (Supervisory Control and Data Acquisition / Energy Management System), si dhe një sërë funksionesh të tjera.

Gjatë vitit 2014 kjo platformë ka qenë në operim të plotë. Aplikacionet e "Network Manager" përdoren gjithashtu për kryerjen e kontrolleve dhe analizave në kohë reale, si dhe për qëllime optimizimi e planifikimi. Këto mjete të fuqishme të operimit të rrjetit na ofrojnë lehtësi e operim efikas ditor.

SCADA (Supervisory Control and Data Acquisition).

Në sistemin e kontrollit të implementuar në OST sh.a. monitorohen dhe operohen në kohë reale të gjitha nënstationet 220/400KV, si dhe pjesa më e madhe dhe më e rëndësishme e nënstacioneve 110KV. Ndër funksionet kryesore që ofron moduli SCADA i "Network Manager" është:

- Grumbullimi i të dhënave nga nënstationet dhe monitorimi i tyre nga Qendra Kombëtare Dispeçer në kohë reale.
- Përveç monitorimit të nënstacioneve të OST sh.a. dhe pjesës më të madhe të nënstacioneve të OSHE në Qendrën Kombëtare Dispeçer monitorohen edhe nënstacione kryesore të Malit të Zi CGES (Montenegrin Control Center), si dhe të Greqisë, IPTO (Greek Control Center).
- Monitorimi i nënstacioneve kufitare mundësohet duke shfrytëzuar rrjetin "Electronic Highway", rrjet i mbyllur ndërmjet OST-ve.

Monitorimi dhe ecuria e ngjarjeve:

- Supervizimi, kontrolli dhe komandimi nga qendra dispeçer;
- Arkivimi i të dhënave dhe i ngjarjeve;
- Llogaritje dhe raporte të dhënash;
- Ndërfaqe grafike ndërmjet përdoruesit dhe "Network Manager"

EMS (Energy Management System).

EMS është paketa e aplikacioneve të rrjetit, e cilat nëpërmjet studimeve të brendshme të sistemit, bazuar në gjendjen aktuale të tij dhe në parametrat e çdo elementi të sistemit energjetik të përfshirë në SCADA, optimizon gjendjen e sistemit. Ky modul përbëhet nga disa aplikacione, të cilat bashkëveprojnë në rrjet me njëra-tjetrën dhe në të njëjtën kohë mund të menaxhohen individualisht nga njëra-tjetra. Ndër aplikacionet kryesore të rrjetit të implementuara në "Network Manager" janë:

- **SNP (Telemetry Snapshot):** Ky aplikacion fotografon gjendjen e sistemit nga telematja dhe ua bën të disponueshme aplikacioneve të tjera të rrjetit.

- **SAR (Status and Analog Retrieval):** Mbledh dhe koordinon të dhënat e fotografuara nga SNP së bashku me të dhënat referencë të gjendura në bazën e të dhënave.

- **NMB (Network Model Builder):** Ky aplikacion ndërton topologjinë aktuale të rrjetit energjetik, bazuar në të dhënat e gjendjeve të çelësave.

- **SE (State Estimator):** Është komponenti kryesor për sa i përket funksionimit të EMS-së, pasi llogarit gjendjen aktuale të sistemit energjetik. Ai bën një vlerësim të përgjithshëm të sistemit energjetik në gjendje të qëndrueshme.

- **SA (Security Analysis):** Nëpërmjet këtij aplikacioni kryhen analizat e sigurisë së rrjetit energjetik.

Automatic Generation Control (AGC): Kontrolli automatik i gjenerimit është moduli, i cili rregullon në mënyrë automatike prodhimin e gjeneratorit, që të mbajë frekuencën dhe shkëmbimin në vlerat e skeduluara. Gjatë vitit 2014 ky modul ka qenë në shfrytëzim të vazhdueshëm, duke pasur nën kontroll tri hidrocentralet më të mëdha të Shqipërisë (Fierzën, Komanin, Vaun e Dejës).

Funksione të tjera të implementuara në paketën "Network Manager"

Veç moduleve kryesore të përmendura më sipër, në "Network Manager" janë përfshirë edhe funksione të tjera, të cilat ndihmojnë në operimin sa më eficient të qendrës së kontrollit dispeçer. Ndër funksionet më kryesore të përfshira janë:

- **ICCP (Inter Control Center Protocol),** i cili mundëson transferimin e të dhënave reale me qendrat e kontrollit të vendeve fqinje, e parashikuar në politikat e ENTSO-E.
- **"Load Shedding"** është një tjetër funksion i implementuar në "Network Manager", me anë të

të cilit është e mundur të stakohen në mënyrë automatike disa elemente të caktuara të rrjetit energjetik, në rastet kur kërkesa për energji është më e madhe se gjenerimi i disponueshëm.

- **STLF (Short Term Load Forecast)** është aplikacioni, i cili, duke u bazuar në të dhënat statistikore dhe në parashikimet e temperaturave, kryen një parashikim mbi ngarkesën e sistemit energjetik për një kohë të shkurtër, për 15 ditë.
- **CF (Congestion Forecast)** është një instrument për analizimin e gjendjes së rrjetit energjetik në të ardhmen.

Ndërfaqësimi me ENTSO-E

OST sh. a., duke qenë pjesë e Rrjetit të Transmetimit Europian dhe në mënyrë për të përmbushur standardet e ENTSO-E, gjatë vitit 2014 ka përmbushur disa detyrime lidhur me ndërfaqësimin me OST-të e tjera, si dhe me vetë ENTSO-E. Në këtë kuadër, OST sh.a. ka implementuar të gjitha kërkesat për të qenë pjesë zyrtare e "Electronic Highway", si dhe ka iniciuar procesimin e të dhënave të nevojshme për Platformën e Transparencës së ENTSO-E.

Electronic Highway

Electronic Highway (EH) është një rrjet i dedikuar i mbyllur ndërmjet OST-ve të Europës. Nëpërmjet këtij rrjeti shkëmbehen të dhëna në kohë reale, si dhe në kohë joreale. Në fillim të vitit 2014 OST sh. a. duke iu përmbajtur direktivave të ENTSO-E ka implementuar një të rrjetit të instaluar në nënstationet "Tirana 2", në Qendrën Kombëtare Dispeçer. Linjat e komunikimit për rrjetin EH janë:

IPTO, Greqi: "Leased Line 10 mbps, PtP"

CGES Mal i Zi: "Private Line over SDH Network 10 mbps, PtP".

Shërbimi i shkëmbimit të të dhënave në kohë reale dhe joreale është implementuar me Malin e Zi dhe Greqinë.

Platforma e Transparencës

Platforma e Transparencës është një platformë qendrore e ENTSO-E në përputhje me rregulloren (EU) nr. 543/2013 për të siguruar akses të vazhdueshëm mbi të dhënat e tregut energjetik në të gjithë OST-të pjesëmarrës. Duke qenë një nga detyrimet që çdo OST duhet të përmbushë, OST sh. a. gjatë vitit 2014 ka iniciuar procesimin e të dhënave në formatet dhe në intervalet e duhura, duke i publikuar më pas në platformën e Transparencës.



4 AKTIVITETI GJATË VITIT 2014 SIPAS SEKTORËVE TË DDOS

Zyra e Dispeçerisë ka bërë drejtimin operativ të punës së bashkërenduar të centraleve elektrike, rrjetit të transmetimit dhe nënstacioneve deri në ndërfaqen me Sistemin e Shpërndarjes. Viti 2014 për punonjësit e Dispeçerisë Qendrore ka qenë një vit i ngarkuar për plotësimin e detyrave parësore të saj, si mbajtja e balancës në SE, krijimi i kushteve për kryerjen e remonteve nga Njësitë Operative të Transmetimit, eliminimi i avarive e defekteve në kohën më të shkurtër të mundshme, komunikimi në mënyrë profesionale me personelin operativ të OST-ve fqinje, skedulimin e programit të shkëmbimit sipas formatit të përcaktuar në

politikën e dytë të Manualit Operacional të ENTSO-E etj. Gjatë këtij viti, përveç remonteve të planifikuara nga Njësitë Operative të OST-së, eliminimit të avarive e defekteve në SE, operatorët kanë qenë mjaft të angazhuar me kryerjen e veprimeve operative për të krijuar kushtet e punës për kontraktorët dhe nënkontraktorët e OST sh.a në implementimin e shumë projekteve për shtrirjen e linjave të reja 110 kV (Unaza e Jugut), fuqizimin e nënstacioneve (Zëmlak, Korçë), si dhe shtrimin e fibrës optike (OPGW).



Zyra e Kontrollit të Zbatimit të Kodit të Rrjetit nga Përdoruesit

Në zbatim të dispozitave të Kodit të Rrjetit dhe në zbatim të politikave të ENTSO-E dhe të Komunitetit të Energjisë, gjatë vitit 2014 (shkurt 2014) për herë të parë brenda Drejtorisë të Drejtimin Operativ të Sistemit, u hap zyra e re e Kontrollit të Zbatimit të Kodit të Rrjetit nga Përdoruesit e Rrjetit të Transmetimit. Kjo zyrë gjatë vitit 2014 ka kryer një sërë aktivitetesh, ku ndër të tjera mund të përmendim:

Organizimin dhe ngritjen e komisionit përkatës për rishikimin e Kodit të Rrjetit dhe administrimin e procesit të rishikimit dhe përditësimit të Kodit të Rrjetit. Bashkëpunimi për hartimin e Marrëveshjeve të ndryshme Bilaterale të Operimit, si dhe të Shërbimeve Ndihmëse me KESH sh.a.

Në zbatim të dispozitave të Kodit të Rrjetit dhe "Marrëveshjeve të Lidhjeve" me përdorues të ndryshëm të Rrjetit të Transmetimit është kryer monitorimi i të gjithë përdoruesve të rrjetit të transmetimit dhe mbledhja e informacionit dhe të dhënave në zbatim të Kodit të Rrjetit. Është kryer monitorimi i niveleve të tensionit 110 kV, 220 kV, 400 kV në nyjat e ndryshme të sistemit dhe në nyjat e ngarkesave dhe Klientëve të Kualifikuar,

si dhe të njëjve të reja gjeneruese (N/S Kukës, HEC Lapaj, HEC Dardha+ HEC Truen, N/S Fushë-Arrëz, HEC Lura 1&2&3, nënstacioni Kalimash etj.);

Është kryer monitorimi i faktorit të fuqisë "Cos φ" me bazë mujore sidomos për Klientët e Kualifikuar (COLACEM, "Antea Cement - Titan grup", "Kurum", GSA, ARMO);

Kontrolli, inspektimi dhe testimi me bazë vjetore i disa prodhuesve të pavarur të energjisë elektrike PPE në zbatim të kërkesave të Kodit të Rrjetit. Kështu janë inspektuar dhe testuar HEC Lapaj, HEC-et e kaskadës Bele 1&2, HEC Dardha, HEC Truen për çështje të menaxhimit të tensionit (aftësia absorbuese për fuqinë reaktive);

Në zbatim të dispozitave të Kodit të Rrjetit të Transmetimit është hartuar dhe paraqitur në ERE "Raporti vjetor për vitin 2014", për Inspektimin dhe Monitorimin e Përdoruesve të Rrjetit të Transmetimit/Pjesëmarrës të Tregut të Energjisë Elektrike dhe Problematikat e konstatuara gjatë kryerjes së monitorimit, testimit dhe inspektimit të tyre (PPE, kompania OSHEE dhe KK).

Zyra e Regjimit të Punës

Bazuar në Kodin e Rrjetit dhe rregulloren e punës të DDO, Zyra e Regjimit të Punës së SE, gjatë vitit 2014 ka kryer një sërë aktivitetesh, ku ndër të tjera mund të përmendim:

Kryerja e llogaritjeve për remonet e kërkuara për çdo element të sistemit të prodhim-transmetimit dhe përcaktimi i masave që duhet të merren në çdo rast për të ruajtur sigurinë e punës dhe nivelin e tensioneve brenda normës.

Plotësimi i bazës së të dhënave me ngarkesat dhe treguesit e tjerë të sistemit, përgatitja e tabelave dhe grafikëve të dinamikës së prodhimit, konsumit, shkëmbimit, kuotës në Fierzë dhe rezervës së kaskadës së Drinit.

Gjatë vitit 2014, OST ka qenë në rolin e Koordinatorit të Grupit të Punës për kordinimin e remonteve për Rajonin e Europës Juglindore, çdo javë në bashkëpunim dhe me Zyrën Dispeçer (çdo ditë të enjte), është realizuar telekonferenca javore me pjesëmarrësit e grupit, ku palët njoftojnë reciprokisht mbi situatën në Sistemin e tyre të Transmetimit (skema e rrjetit, ngarkesat, stakimet

e ndryshme, temperatura e motit, piku i ngarkesës etj).

Kryerja e simulimeve dhe llogaritjeve të ndryshme me anë të softit "TNA Analyzer", si p.sh., llogaritja e NTC, studimi i qëndrueshmërisë statike të SE, por edhe të atij të Europës Juglindore (SEE), duke qenë në rolin e koordinatorit për remonet e planifikuara, si dhe krijimi i modelit mujor në avancë M+2 (krijohet për orën 10:30 të mërkurës së tretë të muajit).

Është bërë përgatitja e materialeve për website të OST (grafiku ditor i ngarkesës i realizuar, tabelat mbi skedulimet finale në linjat e interkonjeksionit dhe mbi kapacitetet e lira në interkonjeksion, për t'u përdorur si skedulim "intraday" në bashkëpunim me grupin e skedulimit).

Ky vëllim pune është kryer nga specialistët e kësaj zyre, por edhe me angazhimin e madh të inxhinierëve të rinj nga Zyra e Shërbimeve, të cilët kanë punuar me pasion në detyrat që u janë ngarkuar, por edhe si pjesëmarrës në Grupet e Punës të ENTSO-E.

IV Mirëmbajtja dhe Shfrytëzimi i Transmetimit

1 Funkzioni i Drejtorisë së Mirëmbajtjes dhe Shfrytëzimit të Transmetimit

Drejtorja e Mirëmbajtjes dhe e Shfrytëzimit të Transmetimit është e organizuar në pesë zyra. Në varësi të kësaj drejtorie janë Njësitë e Mirëmbajtjes së Transmetimit, si dhe Njësitë Operative të Transmetimit. Ky organizim i kësaj drejtorie është i domosdoshëm për të realizuar detyrat e veta funksionale. Kjo drejtori ka këto detyra funksionale:

- Shfrytëzimin optimal dhe mirëmbajtjen e rrjetit të transmetimit dhe nënstacioneve përmes kryerjes së remonteve në linja dhe në pajisjet primare të nënstacioneve.
- Mirëmbajtjen e sistemit të mbrojtjes rële dhe kontroll-monitorimit.
- Shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të telekomunikacionit në shërbim të OST dhe të gjithë Sistemit.

- Kontrollin dhe mirëmbajtjen e sistemit të matjes, së energjisë elektrike, në objektet brenda OST-së, në linjat e interkonjeksionit dhe në kufijtë ndarës me OSHE dhe HEC/TEC-ve.
- Kontrollin dhe zbatimin e të gjitha masave tekniko-organizative për sigurimin teknik në punë.

OST sh. a. ka gjashtë njësi operative në të gjithë vendin, të cilat janë krijuar duke marrë parasysh zonën dhe rëndësinë e nënstacioneve dhe linjave të tensionit të lartë. Njësitë operative janë përgjegjëse për veprimtarinë e OST në rajonet energjetike përkatëse. Ato janë të organizuara, në mënyrë që të kenë pavarësi të mjaftueshme veprimi dhe janë pajisur me mjete, makineri dhe personel të specializuar për të përballuar detyrat dhe përgjegjësitë për mbarëvajtjen e rajoneve që mbulojnë.

2 Asetet e sistemit të transmetimit

Sistemi Shqiptar i Transmetimit përbëhet nga linjat e transmetimit, nënstacionet dhe çdo element tjetër me nivel tensioni nga 110 kV deri në 400 kV.

Më poshtë janë listuar asetet kryesore të Sistemit të Transmetimit:

• Linjat e Transmetimit:

400 kV - 293.6 km;
220 kV - 1150.3 km;
150 kV - 34.4 km;
110 kV - 1405.0 km.

• Transformatorët :

400/220 kV - 1200 MVA;
400/110 kV - 150 MVA;
220/110/20 kV - 440 MVA;
220/110/TM kV - 1920 MVA;
220/20 kV - 126 MVA;
150/110 kV - 40 MVA;

Sistemi Elektroenergjetik Shqiptar operon në mënyrë sinkrone me Zonën Sinkrone të Europës Kontinentale dhe lidhet me të nëpërmjet linjave të interkonjeksionit:

- Linja 400 kV Tirana 2 - Podgoricë (M.ZI)
- Linja 400 kV Zëmlak - Kardia (GR)
- Linja 220 kV Fierzë - Prizren (KS)
- Linja 220 kV Kopluk - Podgoricë (M.ZI)
- Linja 150 kV Bistricë - Myrtos (GR)

3 ORGANOGRAMA

DREJTORIA SHFRYTËZIM - MIRËMBAJTJES TË TRANSMETIMIT



4 Aktiviteti gjatë vitit 2014 sipas sektorëve

Zyra e Linjave, Nënstacioneve dhe e Statistikave

Objekti i punës i Zyrës së Linjave, Nënstacioneve dhe Statistikave është shfrytëzimi, mirëmbajtja e rrjetit të transmetimit të energjisë elektrike.

Kjo detyrë realizohet përmes organizimit të një bashkëveprimi të koordinuar me Njësitë Operative periferike dhe Njësinë e Mirëmbajtjes së Transmetimit, që ka në organikën e saj mjetet e rënda dhe specialistët e përgatitur për ndërhyrje në raste kritike. Gjithashtu, detyrë e rëndësishme është ndjekja në vazhdimësi dhe me vëmendje e problemeve, avarive, mangësive që shfaq sistemi i transmetimit për të programuar ndërhyrjet e nevojshme, për rritjen e sigurisë së furnizimit me energji elektrike me parametra optimalë.

Për cilësinë e punës së Sistemit të Transmetimit janë të rëndësishëm planifikimet e remonteve, planet e të cilave hartohen nga kjo zyrë.

Plani i remonteve të pajisjeve primare të nënstacioneve hartohet duke pasur parasysh informacionin e vazhdueshëm të marrë nga personeli i mirëmbajtjes, si dhe duke respektuar rekomandimet e manualeve të shfrytëzimit të tyre.

Ndërsa për sa u takon linjave të tensionit të lartë, planet e remonteve janë të hartuara duke u bazuar në informacionin periodik të ardhur nga sektorët e linjave

në njësitë periferike dhe nga problematikat e dala në vitet e mëparshme. Janë realizuar të gjitha kontrollet profilaktike dhe remontet e linjave.

Janë analizuar stakimet për avari dhe defektet në nënstacionet dhe linjat e transmetimit, duke u ndalur te veprimet e pajisjeve primare (çelësat e fuqisë) ose veprimet joselektive të mbrojtjeve rële. Pas analizave të avarive janë marrë e zbatuar masat për përmirësimin e gjendjes.

Duhet theksuar se, pas rikonstruksionit të plotë të nënstacioneve në 10 vitet e fundit, në përgjithësi nuk ka probleme të funksionimit me pajisjet primare.

Një problem i rëndësishëm gjatë shfrytëzimit të sistemit të transmetimit është edhe eliminimi i avarive. Linjat kanë një shtrirje të gjerë dhe një pjesë e tyre është e amortizuar nga koha. Shpesh ka pasur defekte dhe avari, të cilat pas identifikimit janë riparuar (eliminuar) nga personeli i vetë Njësiave Operative, në raste të veçanta edhe me mbështetjen e në koordinim me NJMT-në.

Tabela e mëposhtme jep një pasqyrë të punës së defekteve dhe avarive të Sistemit të Transmetimit, duke u fokusuar në linjat e transmetimit dhe pajisjet transformuese.

Emërtimi	Stakime gjithsej	Tranzitore	Qëndrueshme	Stakime që lidhen me linjën			Stakime që s'lidhen me linjën			Të ndryshme	Kohëzgjatja /orë
				Kushte atmosferike	Defekt linje	Mbingarkesa	Pajisje primare	Pajisje sekond.	Person.		
Linja 400kV	21 (4%)	12	9	11	4	0	2	0	2	2	57.5
Linja 220kV	119(25%)	72	47	56	26	0	16	2	8	11	284.5
Linja 110kV	342(71%)	213	129	150	60	22	43	29	5	33	774
Linja gjithsej	482	297	185	217	90	22	61	31	15	46	1116
N/stacione	Çkyoje gjithsej	Tranzitore	Qëndrueshme	Pajisje Primare	Pajisje Sekond.	Mbingarkesa	Kushte atmosferike	Person.	Refuzim qelësi	Të ndryshme	Kohë zgjatja
AUTO, TR	50	23	27	22	4	7	12	2	0	3	159

Gjatë vitit 2014 u kryen punime të paplanifikuara, por shumë të nevojshme për ritjen e sigurisë së furnizimit me energji elektrike:

- Përfundoi zgjerimi i nënstacionit 220 kV Sharrë, duke kaluar nga skema e punës me degëzim në atë me hyrje- dalje të linjës 220 kV, L220 - 13
- Në muajin prill filloi testimi dhe matja e parametrevave teknike të të gjithë AT-ve të sistemit. Në fund të këtij viti kemi një pasqyrë të plotë të gjendjes së tyre teknike.
- U punua me intensitet për plotësimin e të gjitha linjave të transmetimit me tros.
- U kryen punime për zëvendësimin e përcjellësit dhe përforsimin e shtyllave në linjën 110 kV, Rrashbull-Shkozet.
- U punua në kushte të vështira për zëvendësimin e shtyllës nr. 123 të linjës 110 kV Traktora - Ibë; të dëmtuar nga rrëshqitja e dheut.



Zyra e Mbrojtjes Rële

Sektori i Mbrojtjes Rële ka për detyrë mirëmbajtjen dhe instalimin e mbrojtjes rële, e cila është shumë e rëndësishme për punën e sigurt të sistemit të transmetimit. Sistemi Elektroenergjetik Shqiptar është në një zhvillim të përditshëm, ku kohë pas kohe në të lidhen objekte të reja dhe koordinimi i sistemit të mbrojtjes rële për të ruajtur sigurinë e Sistemit Elektroenergjetik Shqiptar, është një detyrë e vështirë dhe e komplikuar dhe kërkon përgatitje dhe formim të lartë teknik, fakt ky që realizohet përmes një pune serioze e të përditshme. Gjatë vitit 2014 Zyra e Mbrojtjes Rële ka realizuar një volum pune që shtrihet në disa fusha.

Objekt i punës sonë gjatë vitit 2014 ka qenë fusha e mbrojtjes rële në të gjitha nënstacionet 400/220 kV të sistemit elektroenergjetik shqiptar.

Përgjatë të gjithë vitit 2014 janë analizuar në mënyrë të përditshme të gjitha sjelljet e mbrojtjeve rële në sistemin energjetik, duke bërë një monitorim të kujdesshëm të veprimeve apo mosveprimeve të rëleve dhe në nënstacione të ndryshme janë bërë ndërhyrjet përkatëse në funksion të sigurisë së sistemit elektroenergjetik shqiptar duke përmirësuar skemat apo ndryshuar tarimet.

Në vitin 2014, Zyra e Mbrojtjes Rële ka ndjekur dhe realizuar sipas planit grafik të remonteve të miratuara të OST sh.a kontrollin e tarimeve dhe sjelljes së mbrojtjeve rële në linjat 220-400kV dhe në pikat më të rëndësishme ku ka pasur probleme apo veprime të pajustificuara të mbrojtjes rële she ka bërë ndërhyrjet përkatëse në funksion të përmirësimit të sigurisë.

Përgjatë vitit 2014 kontrole të sistemit të mbrojtjeve rële janë zhvilluar në nënstacionet e mëposhtme:

Nënstacioni 220 kV Fierzë, nënstacioni 220 kV Fier, nënstacioni 220 kV Elbasan 1, nënstacioni 220 kV Babicë, nënstacioni 220 kV Tiranë, nënstacioni 220 kV Rrashbull, nënstacioni 400 kV Zëmbllak etj.

Gjatë vitit 2014 Zyra e Mbrojtjes Rële ka realizuar një punë të rëndësishme në mbështetjen e drejtorisë përkatëse për implementimin e projekteve të huaja.

Projekti "Shqipëria e Jugut", që po realizohet në dy lote nga kompanitë KONCAR, dhe ENERGOINVEST është njëri prej tyre. Zyra e Mbrojtjes Rële ka dhënë asistencën e nevojshme në kontrollin e miratimit e skemave sekondare, kthimin e përgjigjeve, si dhe ndjekjen në kohë edhe në cilësi të këtyre projekteve.

Gjatë vitit 2014 Zyra e Mbrojtjes Rële ka realizuar trajnimin përkatës për pjesën e mbrojtjes rële dhe kontroll-monitorimit në të gjitha njësitet operative dhe nënstacionet që ka sistemi ynë energjetik, duke i ndihmuar teknikët, inxhinierët dhe specialistët për njohjen dhe përditësimin e tyre me pajisjet e reja.

Zyra e Mbrojtjes Rële ka dhënë gjatë vitit 2014 mbështetjen teknike për të gjithë kryeinxhinierët e njësive operative për zgjidhjen e problemeve të përditshme në mirëmbajtjen e nënstacioneve në fushën e mbrojtjes rële.

Gjatë vitit 2014 zyra jonë ka realizuar përgatitjen e specifikimeve teknike për pajisjet e prokuruar nga OST sh.a në fushën e mbrojtjes rële.

Zyra e Matjes së Energjisë

ZME (Zyra e Matjes së Energjisë) funksionon e ndarë në tri grupe pune:

Grupi teknik

Grupi teknik ka specialistët përkatës që japin mbështetjen teknike për çdo rast të nevojshëm dhe avarie në të gjithë sistemin e matjes së energjisë. Gjatë shfrytëzimit të sistemit të matjes mund të ndeshemi me defekte të pajisjeve të sistemit, si transformatorët e kombinuar CT/VT, matësve digjitalë të matjes së energjisë, sistemit të komunikimit GSM të instaluar në matës. Grupi teknik funksionon gjatë gjithë kohës në koherencë me QME

(Qendra e Menaxhimit të Energjisë) dhe analizon çdo rast anomalie të shfaqur. Pasi QME kryen kontrollin e saj për çdo pikë matjeje, raportin përfundimtar me pikat e matjes që kanë probleme teknike ia kalon sektorit teknik, i cili në prezencë edhe të personelit të autorizuar nga operatorët e lidhur në OST kryen kontrollin në pikën e matjes, si dhe bën riparimin e saj. Pranë këtij grupi pune gjenden të gjitha dokumentet teknik të çdo pike matjeje në sistem. Gjithashtu ky grup pune bën kontrollin periodik në linjat e interkonjeksionit në bashkëpunim me specialistët e vendeve fqinje në të dyja anët e linjave sipas standardeve.




Trakti i matjes në pikën e matjes

Më sipër është paraqitur trakti i matjes, i përbërë nga transformatorët e kombinuar të rrymës e tensionit, sekundarët e të cilëve përdoren vetëm për matje të energjisë, boksi i matësit, i cili përbëhet nga klemiku i testimit, matësi i energjisë, modemi i komunikimit së bashku me antenën e komunikimit, automati trefazor i sekundarit të tensionit.

Grupi i QME (Qendra e Menaxhimit të Energjisë)

Grupi i QME përpunon çdo ditë të dhënat e energjisë në të gjithë sistemin e transmetimit dhe ua dërgon ato çdo ditë operatorëve, të cilët janë të autorizuar. Gjithashtu, pranë kësaj qendre analizohen humbjet e energjisë elektrike në Sistemin e Transmetimit të OST-së. Në këtë zyrë janë instaluar dy servera, të cilët mbledhin të dhënat e energjisë e të gjitha pikave të matjes që disponon OST. Skema e komunikimit të serverit me matësin e instaluar në nënstacion jepet më poshtë.



Skema e komunikimit të serverit.

Në qendër është "COMM Server", i cili me anë të softit "Multi Drive Manager" dhe një skeduli të ndërtuar në këtë program, jep automatikisht të dhënat nga memoria e çdo matësi, dhe ky realizim bëhet në saje të sinjalit GSM të komunikimit ndërmjet modemit që ndodhet në server dhe atij që ndodhet në çdo matës. Të dhënat e marra nga matësi ruhen në "DATA Server".

Laboratori Qendror i Matjeve

Laboratori Qendror i Matjeve disponon etalonët kombëtarë të energjisë. Në këtë laborator bëhen të gjitha kontrollet e pajisjeve matëse të energjisë me klasë saktësie $\leq 0,5 S$

Në laborator testohen të gjithë matësit para se të vendosen në pikën e matjes. Testimi i matësit bëhet duke ndjekur rigorozisht rregullat teknike të testimit dhe kolaudimit të matësit të energjisë. Etaloni i caktuar për testimin e matësive ka klasën e saktësisë 0,02, pamja e tij vizuale paraqitet në figurën 3.



Stenda e testimit të matësit të energjisë.


Zyra e Telekomunikacionit

Në kuadrin e përmirësimit të funksionimit dhe mirëmbajtjes së rrjetit të telekomunikacionit të OST, nga ana e Zyrës së Telekomunikacionit janë arritur disa objektivat, me synim përmirësimin e rrjetit të telekomunikacionit dhe sistemeve të tij, si dhe futjen e sistemeve të reja, me qëllim rritjen e performancës së rrjetit. Gjatë vitit 2014 janë realizuar të gjithë objektivat e planifikuar si:

Përfundimi i punimeve për rrjetin e telekomunikacionit në kuadrin të projektit "SCADA – Qendra e Re Dispeçer"

Pas punës disavjeçare të kryer në kuadrin të projektit "SCADA-Qendra e re Dispeçer", për ndërtimin e rrjetit të telekomunikacionit në funksion të komunikimit të të gjitha nënstacioneve të sistemit energjetik me QDS, si dhe marrjen e të dhënave dhe transmetimin me anë të këtij rrjeti nga nënstacionet dhe HEC-et në sistemin SCADA, u përfundua me sukses instalimi dhe vënia në punë e të gjitha pajisjeve dhe rrugëve të komunikimit të rrjetit të telekomunikacionit.

Skema e Rjetit të Komunikimit



Shtirija e OPGW në linjat 110kV - Lot 1

Instalimi i 170 km OPGW në linjat e 110 kV të Veriut në kuadër të projektit "Shtirija e OPGW në linjat 110kV-Lot 1" është realizuar me sukses dhe tashmë janë në funksion, duke bërë që të realizohen rrugë komunikimi më të shpejta dhe, si rrjedhim, përmirësimin dhe rritjen e performancës së rjetit të telekomunikacionit, si dhe rritjen e sigurisë së komunikimit dhe marrjen e të dhënave nga nënstationet e ndryshme të sistemit. Instalimi i OPGW rit sigurinë në linjat e tensionit të lartë ndaj veprimit të rufeve dhe lidhjeve të shkurtra.

Linjë 110 kV ku është instaluar OPGW



Zgjerimi i rrjetit LAN të OST në të gjitha Njësitë Operative të OST


Në kuadër të modernizimit dhe shtrirjes së teknologjisë së informacionit në të gjithë rrjetin e OST, nga Zyra e Telekomunikacionit u bë zgjerimi i rrjetit LAN të OST në të gjitha Njësitë Operative të OST-së, si dhe nënstationet e saj. Të gjitha linjat e komunikimit të rrjetit LAN janë 10 Mbit/s, duke synuar që për vitin 2015 të rritet shpejtësia në 100 Mbit/s. I gjithë rrjeti u realizua me sukses dhe tashmë është funksional.



Terminale ODF të OPGW.

Mirëmbajtja e rrjetit të telekomunikacionit

Gjatë vitit 2014 janë kryer punime mirëmbajtjeje të planifikuara, në mënyrë që të mbahet në efeciencë të lartë funksionimi i rrjetit të telekomunikacionit. Punime të paplanifikuara janë realizuar në kuadër të riparimit dhe zgjidhjes së defekteve të ndryshme të ndodhura si shkak i dëmtimeve të fibrave optikë nga faktori njerëzor, si dhe nga kushtet e rënda atmosferike.




Zyra e Sigurimit Teknik

Për vitin 2014, Zyra e Sigurimit Teknik të OST kishte objektiva të përcaktuar në kuadër të rritjes së performancës për njohuritë e sigurimit teknik dhe zbatimin e tyre me përpikëri në praktikë. Performanca e OST sh.a. në lidhje me sigurinë në punë është shumë e lartë, ku tregues për këtë performancë është mospasja e asnjë të aksidentuari në punë. Zyra e Sigurimit Teknik funksionon me specialistët e sigurimit teknik në Njësitë Operative ku ushtrojnë kontrole të vazhdueshme si për njohuritë e punonjësve për sigurimin teknik dhe zbatimin e tyre gjatë punës. Gjatë vitit 2014 për njohjen e rregullores së sigurimit teknik kaluan në testim 524 punonjës, të cilët u pajisën me librezë të sigurimit teknik me grupet përkatëse. Për zbatimin e Rregullores së Sigurimit Teknik është ushtruar kontroll gjatë remonteve të linjave dhe nënstationeve.

U realizua shpërndarja e mjeteve të sigurimit teknik për të gjitha njësitë operative, për plotësimin e çdo vendi pune me pajisjet e mjetet e domosdoshme të sigurimit teknik të përcaktuar sipas rregullores.

Gjatë këtij viti një vend të veçantë për zyrën e sigurimit teknik kanë zënë marrëdhëniet me institucionet shtetërore, si: prefekturat, ALUIZN, INUK, Policia e Shtetit, bashkitë, komunat për problematikat e ndërtimeve pa leje nën dhe afër linjave të tensionit të lartë që administrohen nga OST sh.a.



V OPERATORI I TREGUT

1 Funkzioni i Drejtorisë së Operatorit të Tregut

Një rol të rëndësishëm luan edhe Operatori i Tregut, funksionet e të cilit janë duke u zgjeruar gradualisht me hapat e përcaktuar për krijimin e një tregu të lirë dhe konkurrues të energjisë elektrike në Shqipëri, si dhe integrimin e këtij tregu në tregun rajonal të energjisë elektrike.

OST, si Operatori i Tregut, është përgjegjës për:

- organizimin dhe administrimin e likuidimeve dhe pagesave të energjisë elektrike mes pjesëmarrësve të tregut për tregun balancues;
- organizimin e një procesi, ku të gjitha palët të përmbushin Rregullat e Tregut;
- mbajtjen e llogarive në emër të palëve tregtare për energjinë balancuese dhe shërbimet e siguruar

- nga OST-ja;
- menaxhimin e procesit të deklarimit të likuidimeve;
- faturimin dhe mbledhjen e detyrimeve financiare që i detyrohen OST-së nga pagesat e palëve për Shërbimin e Transmetimit, Shërbimet Ndihmëse, pagesat për interkonjeksionet dhe për blerjen e energjisë balancuese sipas kushteve të "Rregullave të Tregut";
- dhënien ose marrjen nga palët që kanë siguruar energji balancuese të blerë nga OST-ja;
- menaxhimin e procesit të mendimit të "Rregullave të Tregut";
- sigurimin e informacioneve të tregut sipas "Rregullave të Tregut";
- kryerjen e funksioneve të tjera që i caktohen nga "Rregullat e Tregut" ose ERE.

2 ORGANOGRAMA




3 Aktiviteti gjatë vitit 2014

Objektivat e aktivitetit të DOT, në zbatim të detyrimeve të saj, gjatë vitit 2014 lidhen me:

- Verifikimin në mënyrë periodike i kërkesave të aktorëve në sektorin e energjisë elektrike për të marrë pjesë në tregun e energjisë elektrike.
- Promovimin e efikasitetit e tregut të energjisë elektrike nëpërmjet zbatimit të Rregullave të Tregut.
- Zbatimin me efikasitet të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike, që të ofrojë përfitime maksimale për të gjithë pjesëmarrësit e tregut.
- Nxitjen e konkurrencës dhe e transparencës efektive midis pjesëmarrësve të tregut të energjisë elektrike në vend.

STRUKTURA E TREGUT




Regjistrimi i Pjesëmarrësve të Tregut

Në vijim të punës për regjistrimin e Pjesëmarrësve të Tregut, deri në fund të vitit 2014, rezultojnë të regjistruar 23 subjekte, të cilat janë licencuar nga ERE në role në treg:

- 11 janë furnizues,
- 19 janë tregtues,
- 7 janë prodhues.

Tregu shqiptar i energjisë elektrike, në përputhje me përcaktimet përkatëse të ligjit, për vitin 2014 rezulton me 9 Konsumatorë të Kualifikuar.

Importi 2014 sipas kategorive



Alokimi i kapaciteteve në interkonjeksione

Në lidhje me alokimin e kapaciteteve në interkonjeksione, për vitin 2014 janë ndjekur procedurat përkatëse, sipas rregullave të miratuara nga ERE me vendim nr. 140, datë 22/11/2013, "Rregullore mbi alokimin e kapacitetit në interkonjeksione"

Në përputhje me këto vendime të ERE-së janë zhvilluar ankandet vjetore, (për periudhën 1 janar deri 31 dhjetor 2014), ankandet mujore, (për çdo muaj), si edhe ankandet ditore (duke filluar nga data 1 shtator 2014 e në vijim).

Në ankandet mujore të zhvilluara nga OST-ja, nga 23 pjesëmarrësit e tregut të regjistruar tek OT, kanë marrë pjesë 13 subjekte.

Në ankand janë paraqitur dhe vlerësuar 1657 oferta, me një total prej 7 209 391 MWh, me një vlerë totale të ofertave 27 030 130 euro.

Kanë rezultuar fituese në ankand 676 oferta, me një total prej 3 765 010 MWh, me një vlerë totale prej 10 657 365 euro.

Evidentojmë se kërkesa e pjesëmarrësve ka qenë më e shprehur në drejtimin importit në Shqipëri, me një vlerë


të ofertave për këtë drejtim prej 21 913 538 eurosh, se 81 % e totalit të ofertave.

Vlen të theksojmë se nuk ka pasur asnjë reklamim, rezervë apo kundërshtim të Pjesëmarrësve të Tregut, pjesëmarrës në ankand, për afatet, procedurat, procesin e zhvillimit të ankandit, procesin e vlerësimit të ofertave, përcaktimit të fituesve dhe çmimeve të ankandit, komunikimit dhe publikimit të njoftimit të ankandit dhe rezultateve të tyre.

Në përputhje me vendimin nr. 61, datë 07/07/2014 të ERE-së, janë hedhur nga OT në ankand ditore kapacitetet e paalokuara në ankandin vjetor, kapaciteti i paalokuar në ankandin mujor të radhës, si edhe kapacitetet "e lira", të cilat nuk janë nominuar në (D-2) nga palët e tregut.

Në total janë hedhur në ankand në ankand ditore 22 831 MWh dhe kanë rezultuar të alokuara me kongjestion 4 97 MWh. Vlera totale e ATC të alokuara në ankandet ditore të OST është gjithsej 17 067 euro.

Të ardhurat nga ankandet e vitit 2014




Disbalancat


Për disbalancat, ERE aprovoi ndryshime të Rregullave të Tregut, të cilat nuk ndikonin në mënyrën e llogaritjeve të disbalancave dhe penaliteteve të Pjesëmarrësve të Tregut në disbalancë, si edhe kompensimin e KESH-it për balancimin e sistemit të transmetimit.

Në tabelat dhe grafikët e mëposhtëm paraqitet një përmbledhje në total të volumeve të devijimeve brenda tolerancës prej ± 3% të Pjesëmarrësve të Tregut, për periudhën janar - dhjetor 2014. Devijimet në këta kufij nuk penalizohen në vlera monetare. Ato kompensohen nga palët në energji.


Disbalancat brenda zonës ± 3%



Disbalancat jashtë zonës ± 3%



Tarifa e transmetimit në milion Lekë




Shërbimet ndihmëse

Shërbimet ndihmëse në sistemin e transmetimit vijuan në procesin e hartimit të kuadrit rregullator. ERE, me vendim nr. 141, datë 26.12.2014, miratoi Tarifën për Shërbimet Ndhmëse, ndërsa me vendim nr. 9, datë 04.02.2015, miratoi marrëveshjen ndërmjet KESH sh.a. dhe OST sh.a. për sigurimin e Shërbimeve Ndhmëse dhe Balancimit të Sistemit Elektroenergetik, e vlefshme për zbatim nga 1 janar 2015.

Shërbimi i Transmetimit

OST aplikon tarifën e transmetimit sipas çmimit të miratuar nga ERE, mbi përdorimin e sistemit të transmetimit nga Pjesëmarrësit e Tregut.

Tarifa e Transmetimit 2014



Transparenca dhe publikimet

Transparenca është aspekt mjaft i rëndësishëm i punës së OT.

Faqja web e OT është pjesë e asaj të OST, në të cilën janë publikuar:

- të dhëna mbi legjislacionin për tregun e energjisë, si ligji për sektorin e energjisë, modeli i tregut, rregullat e tregut, kodet e miratuara të tregut, formatet e kontratave tip të miratuara, vendime të ERE-së etj;
- të dhëna mbi regjistrimin në OT, si procedura e regjistrimit, formatet përkatëse të regjistrimit, lista e palëve të tregut;
- të dhëna mbi ankandet e kapaciteteve në interkonjeksione, si njoftimet për ankandet vjetore dhe mujore, rezultatet e ankandëve vjetore dhe mujore;
- njoftime të ndryshme, që kanë të bëjnë me operimet e ndryshme, të tilla si çmimet për imbalancat etj.

Të dhënat mbahen të publikuara, periodikisht të azhornuara.

OT publikon edhe mjaft informacione të tjera, lidhur me operimet e tregut të energjisë elektrike, procedurat e aplikuar në treg, kontrata tip apo formate dokumentesh.

Ndër objektivat kryesorë të mbështetur nga OST është bashkëpunimi rajonal, pjesëmarrja në grupet e punës rajonale, në mbështetje të direktivave të traktatit të Energjisë Elektrike dhe Sekretariatit të Vjenës.

Sigurimi i platformës elektronike për Operimin e Tregut mbetet prioritet i kërkesave për mbështetjen e punës së DOT, pasi do të shërbejë për rritjen në një nivel më bashkëkohor të komunikimit të Pjesëmarrësve të Tregut me OT, do të rritë volumet dhe cilësinë për informacionet e nevojshme për Operimin e Tregut në mënyrë korrekte dhe transparente, si dhe do të risë performancën e operimit të tregut dhe shmangien e gabimeve të mundshme në përlogaritje.

VI PLANIFIKIMI DHE ZHVILLIMI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT

OST sh. a. zhvillon sistemin e transmetimit në përputhje me kërkesat afatgjata të furnizimit të vendit me energji elektrike, planeve të zhvillimit për burime të reja të energjisë elektrike dhe koordinon zhvillimin e rrjetit të interkonjeksionit me vendet fqinje.

1 Projektet për Zhvillimin e Sistemit të Transmetimit

Përfitimet më të rëndësishme të projekteve të reja janë: reduktimi i energjisë së mos furnizuar dhe ulja e humbjeve në transmetim. Nga viti 2005 deri në vitin 2014 kërkesa për energji elektrike është rritur me 35 %, ndërsa humbjet e energjisë elektrike janë ulur nga 4,56 % në 2,09 %.

Ndërkohë, janë në fazën e implementimit projekte të rëndësishme dhe OST ka një plan të qartë për Zhvillimin e Sistemit të Transmetimit.

2 Projektet në proces implementimi

Linja e interkonjeksionit 400 kV Shqipëri - Kosovë.

Projekti është një investim i Qeverisë Gjermane, financuar nga Banka KfW, 42 milionë euro pjesa shqiptare dhe përfshin:

- Zgjerimin e nënstacionit "Tirana 2" dhe instalimin e një Shunt-Reaktori 120 MVar;
- Ndërtimin e linjës së re ajrore 400 kV Tirana 2 - Kosova B.

Gjatësia e plotë e linjës është 242 km. Pjesa që kalon në territorin shqiptar është 151.5 km, ku 80 km e parë përfshijnë plotësimin e qarkut të dytë të linjës Tiranë-Podgoricë, nga Tirana në Laç Qyrsaqe dhe 71,5 km linjë e re me një qark deri në kufi.



Harta e linjës ajrore 400 kV Tirana 2- Kosova B

Shtrirja e përcjellësit në qarkun e dytë të shtyllave ekzistuese 400 kV



Hedhja e betonit për ndërtimin e bazamenteve të shtyllave të reja


Projekti është në fazën e implementimit dhe linja parashikohet të jetë në operim në fillim të vitit 2016



Përforcimi i rrjetit të transmetimit 110 kV i Jugut të Shqipërisë.

Projekti është një investim i Qeverisë Gjermane, financuar nga Banka KfW me 49 milionë euro, që përfshin:

- Ndërtimin e linjës së re 110 kV Babicë – Sarandë, 104 km;
- Ndërtimin e linjës së re 110 kV Ersekë – Përmet, 55.7 km;
- Rikonstrukcionin e linjës 110 kV Korçë – Ersekë, 39 km;
- Rikonstrukcionin e traktit 110 kV Përmet – Këlcyrë – Memaliaj, 39 km;
- Plotësimin e qarkut të dytë të linjës 110 kV Zemblak – Korçë, 13.4 km.
- Fuqizimin e nënstacionit Zemblak, 150 MVA.



Harta e Jugut të Shqipërisë



Zgjerim i nënstacionit Babicë



Sistemi i tokëzimit në nënstacionin Përmet



Instalimi i transformatorit të ri 150 MVA në nënstationin Zëmbllak

Projekti është në fazën e implementimit dhe parashikohet të përfundojë në fillim të vitit 2016

Ndërtimi i Qendrës së re Kombëtare Dispeçer dhe Zyrat Qendrore të OST

Projekti financohet nga Kooperacioni Italian me 23 milionë euro dhe konsiston në ndërtimin e godinës së Qendrës së re Kombëtare Dispeçer dhe Zyrave Qendrore të OST-së, si dhe ngritjen e një sistemi të ri SCADA/EMS me të gjitha funksionet e tij.

Projekti është në fazën e implementimit. Sistemi SCADA/EMS është instaluar përkohësisht në nënstationin 400 kV "Tirana 2" dhe është në funksionim të plotë.



Projekti i Qendrës së re Kombëtare Dispeçer dhe Zyrave-Qendrore të OST. Godina e Qendrës së Re Kombëtare Dispeçer parashikohet të përfundojë në shtator 2015.

Linja 110 kV Peshkopi – Lapaj.

Projekti financohet me fondet e OST-së me 3,4 milionë euro dhe përfshin:

- Ndërtimin e linjës së re ajrore 110 kV Peshkopi – Lapaj, 27,2 km;
- Zgjerimin e nënstacioneve Peshkopi dhe Lapaj me dy dalje të reja 110 kV respektive.



Shtirja e përcjellësit

Projekti është në fazën e implementimit dhe linja parashikohet të vihet në operim në fund të vitit 2015.

Linja 110 kV Uznovë - Çorovodë

Projekti financohet me fondet e OST me 3.89 milionë euro dhe përfshin:

- Ndërtimin e qarkut të parë të linjës së re ajrore 110 kV me dy qarqe Uznovë – Çorovodë, 33 km;
- Zgjerimin e nënstacionit Uznovë me një dalje të re 110 kV.


Shtyllë me dy qarqe e linjës

Projekti është në fazën e implementimit dhe linja parashikohet të vihet në operim në tetor 2015.

Instalimi i Trosit Optik (OPGW) në linjat e transmetimit

Projekti financohet me fondet e OST me 0.98 milionë euro dhe përfshin kompletimin me 150 km me tros optik të linjave të mëposhtme:

- Linja 220 kV Vau i Dejës – Koplík (kufi)
- Linja 110 kV Lezhë – Bushat
- Linjat 110 kV Laç 2 – Lezhë – Skuraj – Laç 1
- Linja 220 kV Tirana 2 – Sharrë
- Linja 220 kV Tirana 1 – Elbasan 1
- Linja 220 kV Elbasan 1 – Elbasan 2
- Linja 110 kV Babicë – Selenicë



Shtirja e Trosit Optik

Projekti është në fazën e implementimit dhe parashikohet të përfundojë në shtator 2015.




3 Projekte të rëndësishme për zhvillimin e Sistemit Shqiptar të Transmetimit.

Linja 220 kV me dy qarqe Tirana 2 - Rashbull dhe fuqizimi i nënstacionit të Rashbullit.

Ky projekt përfshin:

- Ndërtimin e një linje të re 220 kV me dy qarqe, Tirana 2 – Rashbull, rreth 18 km dhe dy dalje linje të reja 220 kV në nënstacionet respektive.
- Fuqizimin e nënstacionit 220/110 kV Rashbull, 2x150 MVA



Përfitimet: Ky projekt është shumë i rëndësishëm për Sistemin Kombëtar të Transmetimit, sepse zgjidh probleme të tilla, si: mbingarkimin e linjës ekzistuese, përbushjen e kriterit të sigurisë N-1, uljen e humbjeve në transmetim dhe të energjisë së mos furnizuar.


- Përmirëson furnizimin me energji elektrike në një rajon shumë të gjerë që përfshin rrethin e Durrësit, Kavajës, duke dhënë një impakt pozitiv në të gjithë zonën jugore të Shqipërisë;
- Përbush të gjitha kërkesat e legjislacionit shqiptar dhe europian në lidhje me mbrojtjen e mjedisit;
- Do të ketë një ndikim pozitiv në ekonominë e përgjithshme dhe në përmirësimin e cilësisë së jetës për popullsinë shqiptare;
- Do të rrisë mundësitë për zhvillimin e mëtejshëm të turizmit, për shkak të përmirësimit të furnizimit me energji elektrike;

Studimi i fizibilitetit të këtij projekti, financuar nga projektet WBIF, është përgatitur nga konsorciumi COWI / IPF. Projekti do të financohet nga Qeveria Gjermane përmes Bankës KfW. Në vitin 2015 OST do të bëjë përzgjedhjen e kompanisë konsulente.

Përforsimi i rrjetit unazor 110 kV të Tiranës dhe ndërtimi i nënstacionit të ri 400/110 kV Tirana 3

Ky projekt përfshin:

- Ndërtimin e nënstacionit të ri 400/110 kV Tirana 3, 2x150 MVA.
- Demontimin e linjës ajrore ekzistuese 110 kV Tirana 1 – U. Traktora, U. Traktora – Selitë, dhe ndërtimin e linjave të reja 110 kV (afërsisht 17 km linje ajrore me përcjellës ACSR-300 mm² dhe 7 km linje kablore me përcjellës XLPE-1000 mm²).



Diagrami njëfazore i rrjetit unazor 110 kV të Tiranës.


Përfitimet: Tranzitim i flukseve të energjisë nga rrjeti 400 kV i interkonjeksionit në rrjetin kombëtar 110 kV;

- Rritje të sigurisë së operimit të sistemit;
 - Cilësi më e lartë e furnizimit me energji elektrike, si dhe rritja e besueshmërisë së furnizimit për rajonin e Tiranës;
 - Ulje të humbjeve në rrjetin e transmetimit;
 - Ulje të energjisë së mosfurnizuar;
 - Projekti përmbush të gjitha kërkesat e legjislacionit shqiptar dhe evropian në lidhje me mbrojtjen e mjedisit;
- Studimi i fizibilitetit të këtij projekti, financuar nga projektet WBIF është përgatitur nga konsorciumi COWI / IPF. Projekti do të financohet nga Qeveria Gjermane përmes Bankës KfW. Në vitin 2015 OST do të bëjë përzgjedhjen e kompanisë konsulente.


Linja e interkonjeksionit 400 kV Shqipëri - Maqedoni dhe zgjerimi i nënstacionit 400 kV Elbasan 2.

Ky projekt përfshin:

- Ndërtimin e linjës së re ajrore 400 kV, Elbasan 2 - Bitola, afërsisht 151 km, 56 km në territorin shqiptar.
- Zgjerimin e nënstacionit 400 kV Elbasan 2 me dy zbara dyfishje 400 kV, një dalje të re linje 400 kV dhe një shunt-reaktor 120 MVAR.



Harta e linjës 400 kV Elbasan - Bitola



Përfitimet:


- Zhvillimin e rrjetit ekzistues duke mbyllur unazën 400 kV midis Shqipërisë - Maqedonisë - Greqisë;
- Përmirësimin e kapacitetit të rrjetit për t'iu përshtatur ngarkesës së parashikuar dhe rritjes së transitit, si dhe mundësisë së lidhjes së gjeneruesve të rinj, duke përmirësuar kapacitetin transmetues në Shqipëri, Maqedoni dhe në rajonin e Ballkanit në përgjithësi;
- Përmirësimin e besueshmërisë së rrjetit rajonal, sigurisë së përgjithshme të furnizimit, dhe fleksibilitetit në operimin e sistemit elektroenergjetik;
- Uljen e humbjeve në sistemin e transmetimit;
- Përmirësimin e cilësisë së furnizimit me energji elektrike (normalizimi i niveleve të tensionit, stabilizimi i shpërndarjes së flukseve të fuqisë dhe luhatjet e frekuencës etj.);
- Mbështet zhvillimin e tregut rajonal të energjisë në Europën Juglindore dhe krijimin e mundësive tregtare me Bullgarinë dhe Italinë;
- Mbështetje e ndërsjellë midis Maqedonisë dhe Shqipërisë, për shkak të diversitetit të gjenerimit të energjisë elektrike (Shqipëria-Hidro, Maqedonia-Termo);
- Sjell uljen e kostos së sigurimit të kapaciteteve rezervë, si dhe ofrimin e mbështetjes reciproke emergjente.

Studimi i fizibilitetit të këtij projekti, financuar nga projektet WBIF, është përgatitur nga konsorciumi COWI / IPF. OST dhe MEPSO (MK) kanë ngritur grupe të përbashkëta pune për të ndjekur këtë projekt.

Linja e Transmetimit 400 kV Elbasan 2 - Fier.

Rajoni i Fierit do të shndërrohet në një pikë shumë të rëndësishme për lidhjen në të ardhmen të burimeve të reja gjeneruese të energjisë elektrike nga termocentralet me gaz dhe hidrocentraleve të kaskadës së lumit Vjosa. Ky projekt përfshin:

- Ndërtimin e linjës së re ajrore 400 kV, Elbasan 2 - Fier, rreth 70 km, si dhe dy dalje linje 400 kV në nënstationin Elbasan 2 dhe nënstationin Fier.
- Zgjerimin e nënstationit 220 kV Fier, 1x400 MVA dhe lidhjen me rrjetin e transmetimit.



Diagrami njëfazor, 400 kV Elbasan - Fier

Përfitimet:

- Përmirësimi i standardeve të përgjithshme, besueshmërisë, cilësisë dhe efikasitetit të sistemit të transmetimit në zonën qendrore dhe jugore të Shqipërisë;
- Reduktimi i humbjeve në transmetim (ulja e kostos së furnizimit) në zonën qendrore dhe jugore të rrjetit 220 kV;
- Ulje e energjisë së mosfurnizuar për rreth 400 000 konsumatorë;
- Përmirësimi i cilësisë së shërbimit në aspektin ekonomik dhe social;
- Inkurajimi i zhvillimit ekonomik të rajonit qendror të Shqipërisë, për shkak të furnizimit më të mirë me energji elektrike dhe uljes së kufizimeve të ngarkesës;
- Ulje e mbingarkimit të rrjetit 220 kV.

Studimi i fizibilitetit të projektit, të financuar në kuadrin e WBIF është përgatitur nga konsorciumi Mott Mac Donald/ IPF.

Për këtë projekt dhe atë të mësipërm OST është në fazën e negociimit me Bankën KfW, e cila ka shprehur interes në financimin e të dy projekteve.

Komuniteti European do të mundësojë një grand, si pjesë e këtij projekti.

VII Pasqyra financiare

Pasqyra e Pozicionit Financiar


(Të gjitha shumat janë në mijë lekë)

	2014	2013
AKTIVE		
Aktive afatgjata		
Aktive afatgjata materiale	41,746,767	38,827,789
Aktive afatgjata jomateriale	49,489	52,610
Parapagime për furnitorë	1,437,187	2,073,547
Aktive financiare të arkëtueshme	17,957	117,081
	43,251,400	41,071,027
Aktive afatshkurtra		
Inventarët	905,163	907,373
Të arkëtueshme nga klientë dhe aktive të tjera	9,722,496	6,818,595
Aktive financiare të arkëtueshme	104,557	152,611
Mjete monetare në arkë e bankë	1,257,653	467,866
Tatimi i parapaguar mbi fitimin	-	22,530
	11,989,869	8,368,975
Totali i aktiveve	55,241,269	49,440,002
KAPITALI		
Kapitali aksionar	9,694,008	9,694,008
Rezerva të tjera	1,737,442	1,737,442
Rezerva e rivlerësimit	9,069,000	9,093,705
Rezerva ligjore	443,028	364,792
Fitime të mbartura	3,210,680	1,533,991
	24,154,158	22,423,938
DETYRIME		
Detyrime afatgjata		
Huat	21,717,970	20,294,803
Grante qeveritare	591,281	659,906
Të pagueshme tregtare dhe të tjera	491,620	404,502
Provizione	1,183,990	-
Detyrime të shtyra tatimore	1,453,877	1,550,348
	25,438,738	22,909,559
Detyrime afatshkurtra		
Huat	2,658,619	1,558,232
Të pagueshme tregtare dhe të tjera	2,949,525	2,548,273
Detyrime për tatimin mbi fitimin	40,229	-
	5,648,373	4,106,505
Totali i detyrimeve	31,087,111	27,016,064
Totali i kapitalit dhe i detyrimeve	55,241,269	49,440,002

2 Pasqyra e Fitimit (Humbjes)

(Të gjitha shumat janë në mijë lekë)	2014	2013
Të ardhura nga shërbimet e transmetimit	6,718,152	5,514,067
Të ardhura të tjera	169,142	20,372
	6,887,294	5,534,439
Materiale në përdorim dhe konsum	(76,196)	(98,795)
Kosto transmetimi	(392,459)	(422,217)
Shpenzime personeli	(993,115)	(814,804)
Shpenzime amortizimi e zhvlerësimi	(1,609,884)	(1,557,739)
Shpenzime për provizione	(987,596)	-
Shpenzime të tjera	(204,876)	(236,665)
Fitimi operativ	2,623,168	2,404,219
Të ardhura financiare neto	(74,157)	105,795
Shpenzime interesit	(192,278)	(172,944)
Kosto financiare neto	(266,435)	(67,149)
Fitimi para tatimit	2,356,733	2,337,070
Tatimi mbi fitimin	(445,336)	(801,394)
Fitimi neto i vitit	1,911,397	1,535,676

Të ardhurat e OST-së për 2014 (milion Lekë)



Shpenzimet e OST-së për 2014 (milion Lekë)





Operatori i Sistemit të Transmetimit